

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kryeministrit nuk i mjaftojnë më konstatimet. Duhet zgjidhje
ADRESA	https://prapaskena.com/2026/09/07/kryeministrit-nuk-i-mjaftojne-me-konstatimet-duhen-zgj-idhje/
BURIMI	prapaskena.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 19:43:47 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	7 shtator 2026, 08:46:40 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	68d5b505831ed22dfc3639a8a7a7631fe797d7fbfaf3f5d4e545909aa4eb5c62
TEKSTI	2776167408c14e116fae7ed76b897ca9dff7e03a2dbf98f26797e6bcfa0bd37a
PAMJA	5fbc277f7f481f18412c1679a98d58e38843750e8afdd7953253e80ac90a676c

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	50f1ef4eab07fec90a97a9ac5bd0d4fc5b0617f44173820219fb621e02201ec0
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	965b786ec23a8b4bb286f1d277ec370fc2da1c7624603044806722a90083ae20
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/50f1ef4eab07fec90a97a9ac5bd0d4fc5b0617f44173820219fb621e02201ec0>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Kryeministrit nuk i mjaftojnë më konstatimet. Duhet zgjidhje

Analizë

Publikuar: 07/09/2026



Nga Ylli Manjani

Kryeministri ka të drejtë kur thotë se SPAK ka përdorur mediat për të goditur publikisht njerëz që ende nuk janë gjykuar. Ka të drejtë edhe kur denoncon se gjyqtarë dhe prokurorë të posaçëm mbyllen në dhoma pa praninë e palëve dhe marrin vendime që prekin lirinë, reputacionin dhe autoritetin e njerëzve, madje edhe të pushteteve të tjera që Kushtetuta i ka ndarë.

Kam bindjen se Kryeministri ka edhe konstatime të tjera, ndoshta edhe më të rënda, për mënyrën si funksionon sot shteti i së drejtës. Besoj se Ai thjesht ka zgjedhur të mos i nxjerrë të gjitha njëherësh në publik.

Por pyetja është: po pastaj?

Biem dakord me konstatimet. Ato janë serioze, madje alarmante për një shtet kushtetues. Por çfarë ndodh më pas?

Ku ndryshon Kryeministri nga gjithë turma e "flamingove" që dalin të tufëzuara çdo ditë në ekran dhe konstatojnë, amplifikojnë problemet, por nuk ofrojnë kurrë një zgjidhje, sepse nuk kanë as përgjegjësi dhe as drejtim?

Kryeministri nuk është analist televiziv. Aq për pak flamingo pa kokë e pa përgjegjësi. Ai është zyrtari më i fuqishëm politik në Republikën e Shqipërisë. Ai lëviz mekanizmat institucionalë, propozon ligje, ndërmerr reforma, korrigjon deformime. Roli i tij nuk është të bëjë diagnozën, por të nisë trajtimin.

Padyshim që ka një kundërthënie të dukshme tashmë në deklaratimet e Tij.

Me të lexuarat

Rama "djeg" Allajbeun, i heq tenderin 50 milionë euro për sterilizimin në minutat e

Ramat, Besnik Leskaj... dha tender

Besnik Leskaj pasi Leskaj i mori në punë të birin. Postet

Në merrshmi i administratës

Lulzim Caka në prangat e policisë greke për trafik

Rokullinadiga e Ramën në

Arbitrazh: Po na merr aeroportin e Vlorës për t'ia dhënë

biznesmenit

Enri, ri, borxhi i vjetër: si lind

ASHP-ja me gjysmën e ATP-së akoma gjallë brenda saj

Për vite me radhë, Kryeministri ka mbrojtur autorësinë autentike të Reformës në Drejtësi. Ka kërkuar ta konsiderojmë suksesin e tij më të madh politik. Sot, po thotë se institucionet e kësaj reforme drejtohen nga njerëz me maska, që veprojnë fshehurazi dhe pas shpine.

Sigurisht që është kështu dhe, problemi nuk është më një devijim i vogël. Është një krizë e vetë reformës.

Për hir të së vërtetës, nuk është se këtyre institucioneve u mungojnë vetëm maskat. Shpesh u kanë munguar edhe skrupujt në raport me liritë kushtetuese. Këtë e kanë konstatuar edhe vendime të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në raste të ndryshme. Proçesi i rregullt ligjor ka bërë hapa galopantë pas në Shqipërinë e post reformës në drejtësi.

Por, edhe sikur të mbetemi vetëm te konstatimet e Kryeministrit, ato mjaftojnë për të ngritur alarmin. Prandaj pyetja mbetet e njëjtë: çfarë ndodh në vijim?

Imagjinoni ç'u bëjnë vdekatarëve të thjeshtë, kur drejtësia ka njerëz me maska që godasin pushtetin, politikën dhe vetë Kryeministrin?!

Do të vazhdohet t'u lihet "maskave" në dorë drejtësia, ndërsa ato bëjnë kërdinë me vendime të marra larg syrit të publikut dhe larg garancive të procesit të rregullt? Apo do të kuptohet më në fund se me maska nuk ndërtohet as ligj, as drejtësi, e aq më pak një shtet që pretendon të bëhet anëtar i Bashkimit Evropian? Pa proces të rregullt ligjor nuk garantohet as drejtësi sepse çdo kriminel rrezikon të marrë pamjen e "qinjit të urtë", ashtu sikurse çdo i pafajshëm rrezikon të damkoset si kriminel i rrezikshëm. Kjo nuk quhet drejtësi.

Ndoshta gjithçka duhet të nisë me një ndjesë publike. Me pranimin se një pjesë e drejtësisë iu dorëzua njerëzve që e ushtruan pushtetin pa transparencë dhe pa llogaridhënie.

Pastaj duhet diçka më e rëndësishme se ndjesa: një nismë e plotë për rishikimin e mekanizmave që e kanë lejuar këtë sistem të dalë jashtë kontrollit kushtetues.

Problem është sa ekzistenca e drejtësisë së posaçme, aq edhe sjellja e saj sikur është vetë ligji, mbi ligjin dhe jashtë çdo kontrolli.

Duhet zgjidhje, jo më gjetje.

Gjetjet janë bërë. Madje janë edhe më të rënda sesa ato që Kryeministri ka zgjedhur të thotë publikisht. Tani radha është e zgjidhjeve. Dhe për to, përgjegjësia është e Kryeministrit.

TAG:

Ylli manjani



Kur pushteti politik abdikon ndaj atij gjyqësor



John Goci konkurren Donald Trump, sa do të shkojë ankandi?



Demokracia jonë pa hardware dhe software?!

Prapaskena

'Prapaskena' lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. 'Prapaskena' është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe lidhjet e padukshme mes partive politike, mediave të njësuar me interesat klienteliste, krimin dhe biznesit jo të ndershëm, të cilët në bashkëpunim përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.'

Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.

Kategoritë

- [KREU INVESTIGIM](#)
- [KRIM & KORRUPSION](#) [DOSJE ROZË](#)
- [KRYESORE](#) [POLITIKË](#) [EKONOMI](#)
- [ANALIZË](#) [RAJON](#) [KULTURË](#) [SPORT](#)



Email: [\[email protected\]](#)

Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena

[Privacy Policy](#) | [Cookies](#)